

Arsyet pozitive për vaksinimin kundër Covid-19

Përse të vaksinoheni kundër Covid-19? Sepse ka shumë arsye pozitive. Vaksinimi kundër Covid-19 mbron nga një ecuri e rëndë të sëmundjes. Personat e vaksinuar kanë një rrezik shumë më të vogël, që ata të duhet të shkojnë në spital për shkak të Covid-19, sesa personat e pavaksinuar. Vaksinimi është edhe një akt solidariteti. Ai ndihmon që të frenohen ndikimet e pandemisë.



Mbrojtja nga një ecuri e rëndë të sëmundjes

Një sëmundje me Covid-19 mund të jetë shumë e rrezikshme për personat e moshuar dhe ata me sëmundje kronike. Në rast të një infektimi me koronavirus, të rinjtë dhe personat e shëndetshëm kanë simptoma të lehta ose nuk kanë fare simptoma. Por edhe ata mund të kenë një ecuri të rëndë të sëmundjes. Nëpërmjet vaksinimit ju mund të mbron vetën nga sëmundjet e rënda të Covid-19 me shtrimin në spital. Bëni pas imunizimit bazë edhe vaksinimin përtëritës; atëherë ju jeni i/e mbrojtur më mirë dhe për kohë më të gjatë.



Shmangia e pasojave të COVID-19

Pas një infektimi mund të shfaqen probleme shëndetësore që vazhdojnë për kohë të gjatë (pasoja afatgjata të Covid-19) – si për shembull gulçim gjatë punëve të mundimshme ose lodhje. Kjo mund të ndodh edhe te personat e rinj dhe të shëndetshëm. Nëse ju vaksinoheni, ju zvogëloni rrezikun për t'u sëmurur dhe të pasojave të mundshme afatgjata. Në dallim nga kjo, efektet anësore të rënda pas vaksinimit me vaksinat e përdorura në Zvicër kundër Covid-19 shfaqen shumë rrallë. Pasoja të vonshme nuk.



Fitimi i imunitetit në mënyrë të sigurt

Fitimi i imunitetit vetëm nëpërmjet infektimit dhe sëmundjes është e këshillueshme. Sepse kjo mund të rezultojë edhe në ecuri të rëndë të sëmundjes si dhe në pasoja afatgjata. Me vaksinën kundër Covid-19 ju mund të fitoni në mënyrë të kontrolluar një mbrojtje më të mirë dhe afatgjatë, pa rreziqet e një infektimi të pambrojtur me koronavirusin. Vaksinat e përdorura në Zvicër janë të sigurta. Në mënyrë që një vaksinë në Zvicër të lejohet dhe të rekomandohet, duhet që përfitimi i saj të tejkalojë dukshëm rreziqet. Përvoja e deritanishme me këto vakcina e tregojnë këtë qartë.

Edhe personat, të cilët tanimë kanë rezultuar pozitiv me koronavirusin, duhet të lënë të vaksinohen. Kështu edhe ata janë të mbrojtur më mirë dhe për kohë më të gjatë nga një sëmundje e rëndë.



Mbështetja e personelit shëndetësor

Për shkak të pandemisë, personeli shëndetësor dhe sistemi shëndetësor përballen me një ngarkesë të madhe herë pas here. Me mbrojtjen me anë të vaksinimit, rreziku që ju duhet të shkoni në spital për shkak të Covid-19 për ju është shumë më i vogël. Në këtë mënyrë ju ndihmoni në lehtësimin e ngarkesës së sistemit shëndetësor. Trajtime të sëmundjeve të tjera dhe rasteve urgjente janë të mundura edhe më tej.



Mbrojtja e njerëzve në ambientin tuaj

Në javët pas imunizimit bazë respektivisht vaksinimit përtëritës probabiliteti që të infektoheni me koronavirusin është më i ulët. Me këtë edhe rreziku i një transmetimi tek persona të tjerë është më i ulët. Kjo mbrojtje nga infektimi dhe sëmundja e lehtë megjithatë ullet me kalimin e kohës. Rekomandimet e higjienës dhe të sjelljes si shtesë mbesin të rëndësishme, që të mbrohen persona të rrezikuar në mënyrë të veçantë. Për shembull njerëz me një sistem të dobët imuniteti, tek të cilët vakcina nuk ka efekt shumë të mirë. Dhe njerëz, të cilët për arsye mjekësore nuk mund të lënë të vaksinohen, si dhe fëmijë nën moshën 5 vjeç, për të cilët akoma nuk është i mundur vaksinimi. Sa më shumë persona të vaksinohen, aq më pak do të sëmuren me Covid-19 dhe aq më pak do të infektojnë personat e tjerë.



Forcimi i shëndetit mendor

Përhapja e koronavirusit në këtë pandemi ka pakësuar përkohësisht ndjeshëm kontaktet me njerëzit tanë të afërm. Kjo mund të ndikojë në mirëqenien e njerëzve dhe të favorizojë ose të përforcojë sëmundjet mendore. Mbrojtja nëpërmjet një vaksinimi kundër Covid-19 mund të kontribuojë të frika të zvogëlohet dhe ne t'i përjetojmë kontaktet përsëri më të lirshëm. Vaksinimi është edhe një akt solidariteti me të afërmit tanë.



Frenimi i ndikimeve të pandemisë

Vaksinimi është mjeti më efikas që së bashku me rekomandimet e higjienës dhe të sjelljes ta kufizojmë pandeminë dhe në këtë mënyrë t'i rikthehemi gëzimit të shkujdesur të jetës. Me vaksinimin ju jepni një kontribut të rëndësishëm për shëndetin tuaj personal dhe shëndetin e të tjerëve – në Zvicër, në Evropë dhe në botë.

